



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 maj 2014
Nr.ref.:RK628/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI92/13

Parashtrues

Shefqet Tolaj

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të
Gjykatës Supreme, Rev. nr. 272/2011, të 16 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shefqet Tolaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga z. Ndue Thaqi dhe z. Qerim Zogaj, avokatë nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 272/11, të 16 prillit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij më 14 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 272/11, i cili pretendohet t'ia ketë shkelur atij të drejtat e njeriut, të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 korrik 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI92/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH KI92/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 11 shtator 2013, parashtruesi ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata Supreme ishte njoftuar dhe i ishte dorëzuar një kopje e kërkesës.
8. Më 13 shtator 2013, Gjykata kërkoj nga Gjykata Themelore në Prishtinë shkresat e lëndës së kontestit të punës, i cili ishte trajtuar në gjykatat e rregullta, në mes të parashtruesit të kërkesës dhe KEK-ut.
9. Më 18 shtator, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi kopjen e shkresave të lëndës, të kërkuara nga Gjykata.
10. Më 11 dhjetor 2013, KEK-u ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës dhe i ishte dorëzuar një kopje e kërkesës.
11. Më 17 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ishte punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK-u), me kontratë për periudhë të pacaktuar kohore.

13. Më 27 korrik 2003, parashtruesi i kërkesës pasi që kishte pasur disa probleme shëndetësore, pas kontrollit fillestar në Institutin Mjekësor "Galaxy +", ishte hospitalizuar dhe i ishte dashur të operohej. Prandaj, ai kishte qenë në pushim mjekësor deri më 31 tetor 2003.
14. Më 2 dhjetor 2003, menaxherja e Divizionit të Distribucioneve të KEK-ut (ku parashtruesi ishte i punësuar) nxori Vendimin 1348 për shkëputjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, për shkak të *"të mungesave të paarësyeshme nga puna më tepër se 5 (pesë) ditë pandërprerë dhe atë prej dt. 01.09.2003 e deri më 31.10.2003. Një mungesë e tillë nga puna është sanksionuar me nenin 11 par. 11.1 pika (ç) lidhur me par. 11.4 pika (a) të LTHP me nenin 13 par. 1 pika 7 e Rregullores mbi marrëdhënjet e punës dhe Memorandumin mbi zbatimin e procedurës disiplinore të KEK-ut, prot. nr. 388 të dt. 10.02.2003"*.
15. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit të caktuar kohor, u ankua kundër vendimit 1348 të 2 dhjetorit 2003 te menaxheri i Burimeve Njerëzore të Divizionit të KEK-ut.
16. Më 15 janar 2004, Burimet Njerëzore të Divizionit nxorën Vendimin 161, me të cilin *"REFUZOHET kundërshtimi i punëtorit Shefqet Tolaj, si i pa bazë kurse Vendimi i Menaxheres së Divizionit të Distribucioneve nr. 1348 i dt. 02.12.2003 VËRTETOHET"*.
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për *"anulimin e vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënjes së punës dhe për kthimin në punë"*.
18. Më 17 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C1. nr. 261/08 me të cilin *"MIRATOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Shefqet Tolaj, nga Prishtina dhe ANULOHEN si të kundërligjshme vendimet e të paditurës -Korporatës Energjetike të Kosovës sh. a. në Prishtinë me nr. 1348 dt. 02.12.2003 dhe nr. 161 i datës 15.02.2004 me të cilat paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës te e paditura"*.
19. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Komunale theksoi që:

"Gjykata vlereson se në rastin konkret nuk kanë qenë të plotësuar asnjëra nga kushtet e parapara me dispozitat e cituara që paditësit ti ndërpritet marrëdhënia e punës te e paditura. Kjo për shkak sepse në rastin konkret nuk është dëshmuar egzistimi i mungesës të paditësit pa arsye nga puna më shumë se 5 ditë pune pa ndërprerje në çka e paditura i bazon vendimet e veta. Paditësi si provë për sëmundjen dhe operimin ka ofruar fletëlëshimin nga Klinika "Galaksi" në Prishtinë e cila e provon arsyeshmerinë e mungesës së tij nga puna. Dëshmia për sëmundjen dhe operimin e provon gjendjen faktike përkitazi me situatën shëndetësore të paditësit në harkun kohor kontestues, prandaj ajo provë asesi nuk ka mund të injorohet nga e paditura edhe me supozimin se e njëjta nuk i është dorëzuar të paditurës në kohën që ajo e konsideron të domosdoshme. Ligji obligon që punëtori ta njoftojë punëdhënësin për marrjen e pushimit mjekësor, të cilën gjë sipas

dëshmitarit Lutfi Breznica, paditësi e ka bërë nëpërmes tij, prandaj te kjo situatë e paditura është dashur që ta pres provën nga paditësi për mungesën nga puna e jo vetëm të mjaftohet me mungesën e tij dhe të vendosi që t'ia ndërpres marrëdhënien e punës”.

20. Në një datë të pacaktuar, KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit C1. nr. 261/08, të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

21. Më 26 maj 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 1139/2010, duke e hedhur poshtë ankesën e KEK-ut dhe duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

22. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut në Prishtinë theksoi që:

”Sipas vlerësimit të kolegjit, duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se rastet dhe kushtet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të parapara me nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, të cilat nuk plotësohen në rastin konkret të paditësi, që të njëjtit të i ndërprehet marrëdhënja e punës për shkak të mungesave të paarësyeshme. Gjithashtu nuk mund të konsiderohen shkelje të procedurës disiplinore të paditurës, nga se mungesat nga puna për periudhën kontestuese paditësi i ka mbuluar me dëshmi mjeksore. Pastaj gjykata e shkallës së parë me prova ka vërtetuar se e paditura ka qenë e njoftuar për gjendjen e sëmundjes përkatësisht të operimit të paditësit, fakte këto të cilat gjykata i ka vërtetuar me prova dhe dëshmi të dëshmitarëve Fatime Ahmeti dhe Lutfi Breznica. Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë në një situatë të tillë të vërtetuar faktike drejtë i ka zbatuar dispozitat e sipërcekura ligjore për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, si dhe ato të nenit 452 të LPK-se, kur ka vlerësuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit si dhe detyrimin e të paditurës në kompensimin e shpenzimeve procedurale”.

23. Në një datë të pacaktuar, KEK-u parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit Ac. nr. 1139/2010, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

24. Më 16 prill 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 272/2011, me të cilin aprovoi revizionin e KEK-ut dhe anuloi si të paligjshëm Aktgjykimin C1. nr. 261/08, të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Aktgjykimin Ac. nr. 1139/2010, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

25. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme theksoi që: *“Gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të provës së pa pranueshme, kanë pranuar pretendimin e paditësit se me arsye ka munguar nga puna më tepër se 5 ditë rresht, meqë ka qenë i sëmurë, dhe për këtë i është nënshtruar operimit nga zorra qorre, fakte këto të cilat i ka vërtetuar në bazë të fletë lëshimit të ESH "Galaxy" në Prishtinë të datës 22.08.2003, dhe se për faktin se paditësi ka qenë i sëmurë dhe i operuar, paditësi me kohë ka lajmëruar tek e paditura, mirëpo në Rregulloren për Marrëdhënie Pune të paditurës të datës 18.12.2001 e cila ndodhet në shkresat e lëndës, në nenin 10.4, është paraparë që për punëtorët e*

KEK-ut, kompetent për dhënien e pushimit mjekësor është Instituti i Mjekësisë së Punës (IMP). Nga kjo që u tha, rezulton se paditësi nuk ka vepruar në kuptim të nenit 10.4 të kësaj Rregulloreje ma atë se për periudhën kontestuese nuk ka siguruar pushim mjekësor nga Instituti i Mjekësisë së Punës që është në kuadër të paditurës, por arsyetimin për mungesën e tij nga puna e mbështet kryesisht në fletë lëshimin e lartpërmendur në kundërshtim me dispozitën e lartpërmendur të kësaj Rregulloreje, pa siguruar shenjat mjekësore nga instituti i lartë përmendur”.

Legjislacioni i zbatueshëm

26. Gjykata vëren se në kohën kur ka ndodhur ngjarja, ligji i zbatueshëm për këtë çështje ishte Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27).

27. Në Nenin 11 – Shkëputja e kontratës së punës, sipas Rregullores së UNMIK-ut 001/27, *inter alia*, parashihet:

“11.1 Kontrata e punës shkëputet:

...
(ç) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;
...

11.4 Përmbushja e pakënaqshme e detyrave të punës përfshin sa vijon:

(a) mungesën e paarsyeshme nga puna dhe
(b) gabimet e përsëritura, të cilat si të tilla nuk janë të mjaftueshme për ta
arsyetuar largimin nga puna por ato me shpeshtësinë dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës”.

28. Neni 22 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, rregullon çështjen e pushimit mjekësor, ku theksohet:

“22.1 Punonjësi duhet ta njoftojë punëdhënësin për marrjen e pushimit mjekësor brenda 48 orësh.

22.2 Në rastet kur pushimi mjekësor merret për shkak të fatkeqësisë në punë ose të sëmundjes, punonjësit i takon paga/rroga për atë periudhë kohore”.

29. Më 18 dhjetor 2001, KEK-u gjithashtu e aprovoi Rregulloren për marrëdhënie të punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e KEK-ut), e cila i rregullon të drejtat dhe obligimet e punonjësve të KEK-ut.

30. Neni 10 i Rregullores së KEK-ut rregullon pushimin mjekësor për punonjësit e KEK-ut, duke theksuar:

“10.1. Punëtorët kanë të drejtë, më së shumti gjerë në 15 ditë pushimi mjekësor me pagesë për çdo vit kalendarik.

10.2. Përjashtim bënë pushimi mjekësor për lëndim në vendin e punës apo sëmundjes profesionale të fituar në vendin e punës.

10.3. Punonjësi duhet të njoftoi punëdhënësin për marrjen e pushimit mjekësor brenda 48 orëve.

10.4. Për punonjësit e KEK-ut kompetent për dhënjen e pushimit mjekësor është IMP.

10.5. Pagesa për pushimin mjekësor deri në 7 ditë, punonjësit do t'i llogaritet 70%, e pjesa tjetër deri në 15 ditë 90%.

10.6. Pagesa për pushimin mjekësor për lëndim në punë punëtorit i takon 100%”.

31. Në nenin 13 të Rregullores së KEK-ut theksohet që:

“Të punësuarit i ndërpritet kontrata e punësimit në KEK – subjekt:

- Me rastin e vdekjes së punonjësit;*
- Me marrëveshje me shkrim mes punëdhënësit dhe punonjësit;*
- Në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësi;*
- Për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;*
- Me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës së punësimit dhe*
- Sipas fuqisë ligjore;*
- Mungesën e paarsyeshme nga puna më tepër se 5 ditë rresht;*
- Gabimeve të përsëritura të cilat si të tilla nuk janë të mjaftueshme për arsyetuar largimin nga puna por ato me shpeshtësinë dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës;*

....“

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi pretendon që *“Me këtë rast kemi të bëjmë me shkeljen e nenit 49 par 1 dhe nenit 51 të Kushtetutës së R. Kosovës, nga se e drejta e punës dhe mbrojtjes shëndetësore janë kategori të garantuara kushtetuese dhe të parapara me konventat përkatës ndërkombëtare edhe për faktin se të drejtat e theksuara më lartë përbëjnë dy ndër të drejtat më themelore të njeriut, si dhe shkelja e dispozitave themelore të Ligjit Themelor të punës”.*

33. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata *“Të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 272/2011 të datës 16.04.2013 për shkak të shkeljeve të drejtave themelore të njeriut si kategori kushtetuese, lidhur me të drejtat themelore të punës, të mbetën në fuqi Aktgjykimi i shkallës së parë dhe shkallës së dytë të theksuar më lartë, ose çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën kompetente”.*

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata vëren se vendimi i fundit lidhur me rastin është vendimi i Gjykatës Supreme, i 16 prillit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 14 maj 2011. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 16 qershor 2013, që do të thotë se ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës brenda afatit, të parashikuar me nenin 49 të Ligjit.

37. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

...

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

...

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Gjykata vëren se në rastin konkret, gjykatat e rregullta i kanë trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre. Gjykata rithekson se vlerësimi i ligjshmërisë bie në juridiksionin e gjyqësorit të rregullt.

39. Për më tepër, pakënaqësia me vendimin apo thjesht përmendja e neneve ose dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për parashtruesin e kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi duhet të sigurojë një argument bindës dhe të arsyetuar mirë, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin nr. KI185/13, parashtrues KEK-u, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 368/2011, të 18 shkurtit 2014).

40. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta.

41. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër burime të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të

Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

42. Si rezultat i kësaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur dëshmi përcjellëse për shkeljen e pretenduar kushtetuese me vendimin e kontestuar.
43. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani